RAPORT MONITORIMI

FUSHA: SHËNDETËSI



KONTRATA E KONCESIONIT / PPP

Paketa e Kontrollit Mjekësor Bazë “Check-Up”

Paketa e Shërbimeve të Kontrollit Mjekësor Bazë
për Grupmoshat 40–65 vjeç

VLERA E KONTRATËS

8,8 miliardë lekë
62,5 mil. EUR

AUTORITETI KONTRAKTOR

Ministria e Shëndetësisë
dhe Mbrojtjes Sociale

AFATI

Janar 2025
deri 2027

www.opc.al

Centre for Legal Empowerment
www.cle.al

ALBANIAN INSTITUTES for Research

Kingdom of the Netherlands

RAPORT MONITORIMI

Kontrata e koncesionit: Paketa e Shërbimeve të Kontrollit Mjekësor Bazë për Grupmoshat 40-65 vjeç (Check-Up).

1. Hyrje

Ky raport mbështetet në **Metodologjinë për monitorimin financiar të kontratave të koncesioneve dhe PPP** dhe në kontratën e koncesionit për Paketën e Sherbimeve të Kontrollit Mjekësor Bazë për Grupmoshat 40-65 vjeç "Check-Up". Ky raport njëkohësisht shërben si model për zbatimin e strukturës së metodologjisë (pesë fushat e monitorimit, indikatorët bazë dhe formati PPP-ID) dhe si udhëzues për replikimin e metodologjisë për kontrata të tjera të ngjashme afatgjata të investimeve në infrastrukture koncesione apo PPP.

Analiza mbështetet kryesisht në dokumentacionin zyrtar të përcjellë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) në përgjigje të një kërkese për informacion sipas Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit"[1]: kontrata bazë e koncesionit, kontrata e financimit të koncesionarit, kontrata shtesë e vitit 2016 dhe një tabelë e detajuar e pagesave totale për periudhën 2015–2025. Gjithashtu, në këtë raport janë përdorur gjithashtu burime plotësuese nga raportet zyrtare të Ministrisë së Financave (RVP dhe DRF)[2] dhe gjetje nga raporte të ndryshme të KLSH-së. Për të patur një panoramë sa më të gjërë lidhur me këtë kontratë, në raport janë përdorur të dhëna nga burime alternative si publikime, kronika apo investigime mediatike atje ku janë gjykuar të rëndësishme për të plotësuar analizën duke referuar burimet përkatëse në çdo rast.

Çfarë ofron dhe çfarë nuk zëvendëson ky raport

Raporti ofron një panoramë të strukturuar, faktike dhe të krahasueshme të strukturës së kontratës, angazhimeve financiare, mekanizmit të pagesës, riskut fiskal dhe transparencës.

Ky raport nuk zëvendëson auditimin financiar, ekonomik apo ligjor, as analizat e detajuara të flukseve të parasë apo krahasuesin e sektorit publik (PSC). Gjetjet në këtë dokument duhen lexuar si bazë për debat, monitorim dhe kërkim të mëtejshëm.

[1]MSHMS, Shkresë përcjellëse nr. 2224 Prot., datë 04.05.2026, "Kthim përgjigje", drejtuar "Centre for Legal Empowerment", në përgjigje të kërkesës për informacion sipas Ligjit nr. 119/2014.
[2]Raporti Vjetor i Përmbledhur i Performancës së Kontratave të Koncesionit dhe Partneritetit Publik-Privat (RVP) për dhe Deklarata e Risqeve Fiskale (DRF)

2. PPP-ID

Tabela e mëposhtme përmbledh të dhënat kryesore identifikuese, financiare, fiskale dhe operacionale të kontratës.



3. Fushat e monitorimit

Fusha I: Struktura e kontratës

Kontrata e koncesionit u nënshkrua më 7 janar 2015 ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë (sot MSHMS) si autoritet kontraktues dhe shoqërisë **3P Life Logistic sh.p.k.** si koncesionar e cila është shoqëri e regjistruar në dhjetor 2014, me ortakë **Marketing & Distribution sh.p.k. (80%) dhe Trimed sh.p.k. (20%)**. Objekti është ofrimi i paketës së kontrollit mjekësor bazë, i financuar nga buxheti nëpërmjet FSDKSH-së[3] dhe i ofruar falas për përfituesin.[4]

Kontrata është **propozim i kërkuar** (procedurë konkurruese) dhe është nënshkruar në 7 Janar 2015 për një kohëzgjatje **10-vjeçare** nga data efektive (jo më vonë se 31 mars 2015). Është kryesisht kontratë shërbimi/disponueshmërie pa fazë të konsiderueshme ndërtimi. Vetë kontrata e përshkruan shërbimin si rreth 10% analiza mjekësore dhe 90% logjistikë (furnizim, transport mostrash, sistem informatik dhe mirëmbajtje).

Pas nënshkrimit fillestar ka ndodhur **një ndryshim formal** thelbësor nëpërmjet kontratës shtesë të 30 Nëntorit 2016, në zbatim të VKM nr. 721/2016. Ky ndryshim **zgjeroi ligjërisht**

[3]Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH)
[4]Kontratë Koncesioni nr. 3082/20 Prot., datë 07.01.2015, ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe 3P Life Logistic sh.p.k.; Kontratë për financimin e koncesionit (FSDKSH – 3P Life Logistic), datë 08.01.2015.

grupmoshën e përfituesëve nga 40–65 në 35–70 vjeç dhe shtoi në paketë dy analiza të reja, **duke e mbajtur çmimin për njësi të pandryshuar**.[5] Pra ky është zgjerim i mbështetur në akt ligjor dhe jo një devijim apo anomali e kontratës dhe i kërkuar nga vetë autoriteti kontraktor.

Një tjetër zhvillim i rëndësishëm nga pikëpamja kontraktuale është dhe rishikimi i kohëzgjatjes fillestare 10-vjeçare, afati zyrtar i kontratës **u zgjat de facto deri në vitin 2027**, si kompensim automatik për periudhën gjatë së cilës shërbimi u pezullua për pandeminë (mars 2020–shtator 2021, rreth 17 muaj). Sipas raportimit mediatik, ky është një shtyrje që i lejon koncesionarit ofrimin e shërbimit edhe për rreth dy vite shtesë pas 2025-ës.[6] Lidhur me këtë ndryshim nuk ka asnjë dokument zyrtar të publikuar apo të përcjellë për informacion nga MSHMS.

Fusha II: Angazhimet financiare të shtetit

Modeli financiar ndërtohet mbi një çmim njësi prej **1,537 lekë pa TVSH** për analizë dhe një volum të projektuar prej **475,000 kontrolle në vit**. Nga kjo rrjedh një **angazhim minimal vjetor i garantuar prej 730,075,000 lekë pa TVSH (ose gati 876,090,000 lekë me TVSH)**. Sipas kontratës shteti mban detyrim minimal pagese edhe nëse numri real i kontrolleve është më i ulët. Investimi fillestar **(gati 172 milionë lekë)** është ndjeshëm më i ulët krahasuar me pagesat e përsëritura vjetore që është kryesisht tipar i kontratave të disponueshmërsë ku barra kryesore është pagesa korrente, jo kosto kapitale. Përveç investimit fillestar, në çështjet financiare të anekseve të kontratës parashikohet edhe një detyrim riinvestimi prej 15% të vlerës së investimit në secilin nga vitet 7–10 (32,5 milionë lekë/vit, gjithsej 130 milionë lekë), që e çon angazhimin total kapital të koncesionarit në rreth **302 milionë lekë** gjatë kohëzgjatjes së kontratës

Sipas tabelës zyrtare të pagesave të MSHMS, pagesat totale faktike për periudhën **2015–2025 arrijnë në 8,052,908,594 lekë**. Vitet e plota operacionale qëndrojnë rreth nivelit të garantuar (876 milionë lekë/vit), me dy vite dukshëm më të ulëta gjatë pandemisë.[7]

Mbi vlerën e këtij projekti, duke qenë edhe për shumë raste qendër e debateve politike, burime të ndryshme i referohen shifrave të ndryshme lidhur me vlerën e projektit nga 63 milionë euro (sipas vetë koncesionarit) dhe 72.4 milionë euro (sipas organizatave të shoqërisë civile), deri te shifra më të larta të cituara në kontekst politik. **Shifra më e qëndrueshme mbetet totali faktik i pagesave të dokumentuara nga MSHMS: 8,052,908,594 lekë për 2015–2025.** Megjithatë, kjo shifër përfshin vetëm pagesat e kryera dhe nuk konsideron pagesat e planifikuara për muajt e mbetur deri në përfundim të

[5]Kontratë shtesë nr. 5318/3 Prot., datë 30.11.2016, në zbatim të VKM nr. 721, datë 12.10.2016, që ndryshon VKM nr. 185, datë 02.04.2014.
[6]"Rama shtyn koncesionin e Check-up deri më 2027", Lapsi.al, 14.11.2024 - https://lapsi.al/2024/11/14/rama-shtyn-koncensionin-e-check-up-deri-me-2027/
[7]MSHMS, "Pagesat total kontrata e kontrollit mjekësor bazë (Check-up)", tabelë e detajuar e pagesave 2015–2025 (përcjellë me shkresën nr. 2224 Prot.).

kontratës. Mungesa e një vlere të vetme zyrtarisht të publikuar është në vetvete tregues i transparencës së kufizuar.[8]

Viti	Paguar (lekë)	Koment
2015	591,836,599	Vit i parë i operimit.
2016	803,075,732	Ngritje drejt nivelit të plotë
2017	876,082,619	Vit i plotë (niveli i garantuar)
2018	876,082,619	Vit i plotë
2019	876,082,619	Vit i plotë
2020	322,321,810	Rënie gjatë pandemisë COVID-19
2021	219,020,655	Nën nivelin e garantuar. Rifillim shërbimi në Shtator 2021
2022	876,082,623	Rikthim në vit të plotë
2023	876,082,622	Vit i plotë
2024	876,082,622	Vit i plotë
2025	860,158,073	Pagesë pranë vitit të plotë (përfundim)
TOTALI	**8,052,908,594**	**Pagesa totale 2015–2025 (MSHMS)**

Kontrata shtesë e vitit 2016-ës shtoi gjithashtu një **mekanizëm mbartjeje/kompensimi** që nëse në një vit kryhen mbi 475,000 analiza, vlera e analizave shtesë kompensohet me vlerën e analizave të pakryera në vitet e mëparshme. Ky mekanizëm nuk e heq detyrimin minimal vjetor, por krijon fleksibilitet kontraktual për mbartjen e vlerës ndër vite.

Fusha III: Mekanizmat e pagesës

Operatori paguhet **drejtpërdrejt nga buxheti i shtetit nëpërmjet FSDKSH-së**, jo nga përdoruesit duke e bërë këtë shërbim pa pagesë të drejtpërdrejtë nga qytetari. Kjo e vendos kontratën te modeli i **pagesës për disponueshmëri**, ku kostoja e kontratës mbartet nga shteti. Pagesa kryhet mbi bazë mujore, e shpërndarë proporcionalisht përgjatë vitit, e shoqëruar me rakordim vjetor. Lidhur me pagesat e vonuara, ato i nënshtrohen një kamate 2% në vit sipas kontratës së financimit.

Kontrata parashikon **rishikim vjetor të çmimit sipas inflacionit** (pa ndryshim kur inflacioni është 0–0.5%), por nga dokumentacioni i mbledhur nuk del një formulë e shprehur indeksimi

[8]Vlera totale e kontratës është paraqitur ndryshe nga burime të ndryshme nga 72.4 mln euro (Citizens.al / Together for Life - https://citizens.al/2022/12/28/raporti-shendetesia-me-koncension-i-kushton-miliarda-leke-taksapaguesve/) ; në 63 mln euro sipas vetë koncesionarit (Report-tv.al - https://report-tv.al/lajm/koncesioni-i-check-up-shoqeria-3p-life-logistic-shpk-i-qendrojme-akuzave-per-shpifje-ndaj-albana-vokshit); shifra më të larta (130–138 mln euro) janë cituar në kontekst politik/mediatik. Pagesat faktike të dokumentuara 2015–2025 = 8,052,908,594 lekë (MSHMS).

e zbatuar realisht, dhe çmimi për njësi mbeti i pandryshuar përmes ndryshimit të 2016-ës. Kontrata nuk parashikon tarifë koncesionare duke e përjashtuar shprehimisht këtë shërbim nga çdo tarifë koncesionare, në zbatim të Ligjit nr. 88/2014, datë 17.07.2014 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.125/2013, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat". Ndërkohë, anekset e çështjeve financiare parashikohet një penalitet prej 25.000 lekësh për çdo javë vonese të koncesionarit në përmbushjen e afateve kontraktore (java e parë e përjashtuar). Përveç elementeve të mësipërme, nuk evidentohet ndonjë skemë bonusi e lidhur me rezultatet shëndetësore.

Devijimi pagesa faktike vs. e garantuar

Në vitet e plota (2017–2019, 2022–2024) pagesa faktike është 100% e nivelit të garantuar. Gjatë pandemisë devijimi është i konsiderueshëm: **2020 gati 37% dhe 2021 gati 25%** e një viti të plotë si pasojë e drejtpërdrejtë e pezullimit të shërbimit.[9]

Një tipar qendror i mekanizmit të pagesës është se **operatori paguhet sipas numrit të planifikuar (475,000) dhe jo sipas kontrolleve të kryera faktikisht**. Pavarësisht që në kontratën e financimit ka një proces rakordimi të numrit të analizave të kryera dhe nivelit minimal të garantuar. Të dhënat nga Raporti Vjetor i Përmbledhur i Performancës së Kontratave të Koncesionit/PPP (RVP) 2023 dhe 2024 tregojnë se projeksioni vjetor nuk u arrit deri në vitin 2019:

Viti	Kontrolle të kryera	Kundrejt 475,000 të paguara
2015	244,420	Gati 51% e projeksionit
2016	329,555	Gati 69% e projeksionit
2017	316,601	Gati 67% e projeksionit
2018	428,891	Gati 90% e projeksionit
2019	482,716	Viti i parë i tejkalimit të nivelit minimal të garantuar.[10]
2020	101,426	Pezullim nga pandemia COVID-19. Gati 21% e projeksionit
2021	164,928	Vijim i pezullimit nga Pandemia. Gati 35% e projeksionit

[9]MSHMS nuk ka publikuar apo përcjellë dokumente lidhur me procedurën e pezullimit, hapat e ndërmarra gjatë pandemisë COVID-19 dhe shtyrjen e operimit të kontratës për kompensimin e kësaj periudhe pezullimi.
[10]Në raportin përfundimtar të auditimit FSDKSH të KLSH për 2019-2020 ka një mospërputhje lidhur me realizimin e kontrolleve, por KLSH e konfirmon tejkalimin në Raportin përfundimtar të auditimit të FSDKSH për vitin 2024 (https://klsh.org.al/raport-perfundimtar-auditim-perputhshmerie-fondi-i-sigurimit-te-detyrueshem-te-kujdesit-shendetesor-fsdksh/) që përkon me numrin e raportuar në RPV 2024 të Ministrisë së Financave.

Viti	Kontrolle të kryera	Kundrejt 475,000 të paguara
2022	454,828	Rikthim në operim normal. Gati 96% e projeksionit
2023	467,663	Vit në operim normal. Gati 99% e projeksionit
2024	461,376	Vit në operim normal. Gati 97% e projeksionit

Sipas përllogaritjeve, çmimi për njësi prej 1,537 lekë pa TVSH i përgjigjet **≈ 1,844 lekë me TVSH për kontroll të planifikuar**. Pra kur kontrollet faktike janë nën projeksion, diferenca paguhet njësoj. Kjo shpjegon edhe faktin që KLSH e trajton një pjesë të pagesës si "shërbim të pakryer".[11]

Fusha IV: Risku fiskal

Sipas ndarjes kontraktuale, tek pala private janë transferuar **risku i ndërtimit, i operimit/performancës dhe i transferimit të aseteve**. Autoriteti kontraktor që në këtë rast përfaqëson palën publike i janë alokuar **risku i ndryshimeve ligjore, risku material nga vendimet politike dhe risku financiar**. Ndërsa ndahen mes palëve **risku i kërkesës, i forcës madhore, i rinegocimit, i ndërprerjes dhe i lejeve/licencave**.

Megjithëse risku operacional duket formalisht i kaluar te privati, **minimumi vjetor i garantuar i pagesës** bën që një pjesë e rëndësishme e riskut të kërkesës të ndahet *de facto* me shtetin. Nga dokumentacioni nuk identifikohet që lidhur me këtë kontratë të ketë garanci huaje apo garanci të tjera shtetërore.

Gjatë operimit, risku nuk ka mbetur vetëm teorik dhe kontraktual por në vitit 2020 u **materializua forca madhore (COVID-19)**, me pezullim të përkohshëm të shërbimit dhe rifillim në muajin Shtator 2021. Kjo konfirmohet edhe nga rënia e pagesave për 2020–2021. Gjithashtu, kjo kontratë figuron në **Deklaratën e Risqeve Fiskale 2023/2024** si PPP aktive me mbështetje financiare nga buxheti, çka tregon se vetë Ministria e Financave e trajton si burim risku fiskal dhe monitoron si pjesë e planifikimit buxhetor afatmesëm.[12]

Fusha V: Transparenca dhe vlera e parasë publike

Kontrata e plotë nuk është **lehtësisht e aksesueshme publikisht** si në faqen zyrtare të MSHMS apo në faqen respektive të përcaktuar në Ligjin Nr.88 të vitit 2025 për krijimin e një bazë të dhënash elektronike të të gjitha kontratave koncesionare/PPP të dhëna në Shqipëri, e mbajtur nga institucioni përgjegjës (ATRAKO).[13] Kontrata e projektit dhe anekset

[11]Përllogaritje të bazuara në të dhënat e raporteve të Ministrisë së Financave dhe Raporteve të Auditimit të KLSH. Më e detajuar në Fushën V: Transparenca dhe vlera e pasurisë publike.
[12]Ministria e Financave, Raporti Vjetor i Përmbledhur i Performancës së Kontratave të Koncesionit/PPP (RVP) 2023 dhe 2024; Deklarata e Risqeve Fiskale (DRF) 2023 dhe 2024.
[13]Ligji nr. 88/2025 "Për koncesionet dhe partneritetin publik-privat" parashikon krijimin e një baze elektronike të të dhënave për kontratat koncesionare/PPP, të mbajtur nga ATRAKO. Aksesuar në datën 15 Qershor 2026 në faqen zyrëtar të MSHMS - https://shendetesia.gov.al/ dhe ATRAKO - https://atrako.gov.al/

plotësuese u sigurua nga MSHMS vetëm pas një kërkese për informacion sipas Ligjit nr. 119/2014. VKM-të e dhënies (185/2014 dhe 721/2016) janë të publikuara në Fletoren Zyrtare. Nga të gjitha burimet e siguruara dhe të analizuara deri tani nuk gjendet publikisht ndonjë analizë e studimit të vlerës së parasë (VfM) apo krahasues i sektorit publik (PSC) i bërë para nënshkrimit.

Një element i rëndësishëm lidhur me transparencën është fakti që sipas shkresës përcjellëse të MSHMS, **Dokumentet Standarde të Tenderit (DST) nuk disponohen fizikisht nga autoriteti**, pasi dokumentacioni origjinal lidhur me procedurën e tenderimit është sekuestruar nga SPAK në kuadër të hetimeve në vijim të këtij projekti.

Raportimi mbi performancën e projektit është relativisht i rregullt dhe paraqitet kryesisht në RVP 2023/2024 ku janë përfshirë të dhëna plan/fakt për pagesat dhe kontrollet, gjithashtu kontrata është e përfshirë në DRF e listuar në seksionin e PPP-vë me mbështetje buxhetore. Elementë kryesorë të operimit të kësaj kontrate paraqiten edhe në raportet e KLSH mbi auditimin e FSDKSH. Nga këto auditime KLSH ka konstatuar se **koncesionari është paguar sipas projeksionit dhe jo sipas kontrolleve të kryera, duke marrë pagesa për shërbime të pakryera**. Sipas vlerësimeve të KLSH, mbipagesa kumulative afro **930 milionë lekë për 2015–2019** (përfshirë TVSH-në e faturuar mbi shërbimin e pakryer)[14]. Duke konsideruar dhe vijimin e kontratës për vitin 2022, 2023 dhe 2024 evidentohen respektivisht 20,172, 7,337, 13,624 raste të pakryera që sipas vlerësimeve për këtë raport nga viti i parë i operimit deri në vitin 2025, këto mbipagesa arrijnë një vlerë kumulative **rreth 809 milion lekë**.[15] Një tjetër elemet që evidentohet përkundrejt objektivit kryesor të projektit është që pavarësisht shtimit të kontrolleve, treguesit e sëmundshmërisë kronike nuk janë përmirësuar dukshëm, dhe KLSH ka rekomanduar rishikimin e kushteve të kontratës, sidomos pagesën vetëm për koston variabël të kontrolleve realisht të kryera.[16]

Më gjerë, procedura e dhënies së këtij koncesioni ka qenë objekt **shqyrtimi mediatik dhe i një komisioni hetimor parlamentar**, ndërsa siç u përmend më lart dokumentet e tenderit janë sekuestruar nga SPAK. Këto rrethana paraqiten këtu si fakte konteksti që prekin transparencën dhe verifikueshmërinë. Poashtu nga raportimet mediatike koncesionari nga ana e tij ka kundërshtuar publikisht disa nga shifrat dhe pretendimet. Ky raport nuk merr qëndrim mbi përfundimet e këtyre proceseve.

4. Indikatorët bazë financiarë dhe fiskalë

Indikatorët janë llogaritur me të dhënat e disponueshme zyrtare.

[14]Raport Përfundimtar i Auditimit ushtruar në subjektin "FSDKSH" - https://klsh.org.al/raport-perfundimtar-i-auditimit-te-ushtruar-ne-drejtorine-e-pergjithshme-te-fsdksh/

[15]Llogaritje të autorit bazuar në të dhënat e raportuara në Raportet e Ministrisë së Financave dhe Raporteve të auditit të KLSH.

[16]KLSH 2022: "U faturuan mbi 20 mijë raste pa analiza", Panorama.com.al - https://www.panorama.com.al/u-faturuan-mbi-20-mije-raste-pa-analiza-raporti-i-klsh-per-check-up-ne-2022-koncesionari-u-pagua-per-sherbime-te-pakryera/

Indikatori	Vlera për Check-Up	Interpretimi / pragu
Vlera e projektit në raport me Produktin e Brendshëm Bruto (PBB)	**8.76 miliardë Lekë / 1,435 miliard Lekë (0.63%)**	Ky është një indikator informues lidhur me peshën relative që vlera e projektit zë në PBB-në e vitit të nënshkrimit.[17]
Pagesa totale 2015–2025	**8,052,908,594 lekë**	Në total nën 1% të GDP në periudhën e nënshkrimit.
Vlera e projektit në raport me totalin e investimeve publike	**8.76 miliardë / 66 miliardë Lekë (13,27%)**	Ky është një tregues informues lidhur me peshën relative që vlera e projektit ka në raport me totalin e investimeve në vitin e nënshkrimit.
Pagesë vjetore / të ardhura tatimore	**Pagesa prej 876 mln lekë/vit. (0.3% për vitin 2025)**	Nën pragun tavanin ligjor 5% të portofolit
Devijim kostoje (çmimi për njësi)	**0% (i pandryshuar)**	Nën pragun 20% si shenjë alarmi (zgjerimi i shërbimit ka ndodhur pa ndryshim çmimi)
Devijim afati (ndërtim)	**Pa fazë ndërtimi**	Ndërprerje operacionale gjatë 2020 deri në Shtator 2021 (forcë madhore)
Pagesa realizuar / planifikuar	**100% (vite normale); 37% (2020), 25% (2021)**	Brenda normës në vite normale. Rënie nga pezullimi COVID-19
Kontrolle faktike / të paguara	**51–90% (2015–2018). Mbi 100% (2019)**	Projeksioni 475,000/vit i papërmbushur deri 2019 - burim mbipagese
Mbipagesë për shërbim të pakryer (KLSH)	**930 mln lekë (2015–2019) sipas KLSH. 809 milion lekë deri në 2025[18]**	Tregues i dobët i vlerës së parasë publike që gjithashtu përfshin TVSH mbi shërbim të pakryer (vërejte edhe nga KLSH)
Garanci shtetërore / vlerë kontrate	**Asnjë e identifikuar (0%)**	Risk kërkese i ndarë de facto nga minimumi i garantuar

[17] Të dhënat mbi PBB-në dhe Investimet publike janë marrë nga tabelat e tregueseve fiskalë të konsoliduar në materialet e Buxhetit Vjetor nga Ministria e Financave. https://financa.gov.al/buxheti-ne-vite/

[18] Llogaritje të autorit mbi bazën e raportimeve vjetore nga MSHMS dhe raporteve të Ministrisë së Financave.

Indikatori	Vlera për Check-Up	Interpretimi / pragu
Indeksi i transparencës *(vleresim i autorit 0-5)*	**3 / 5**	VKM, raporte vjetore, raporte KLSH publike. Kontratë jo publike, pa analiza VfM apo të krahasuesit publik të disponueshme

Tavani fiskal ligjor: pagesat vjetore neto nga kontratat koncesionare/PPP, si rregull, nuk duhet të tejkalojnë 5% të të ardhurave tatimore të vitit paraardhës.[19]

5. Elementë sinjalizues (Red Flags)

Sinjale alarm	Prezent?	Vërejtje
Kontratë e papublikuar / me mangësi aksesi	Po	E sigurueshme vetëm me kërkesë. Jo lehtësisht publike
Amendamente të shumta pas nënshkrimit	Jo	Një ndryshim formal (2016), i mbështetur në VKM, pa rritje çmimi
Devijim kostoje mbi 20%	Jo	Çmimi për njësi i pandryshuar
Devijim afati mbi 6 muaj	Pjesërisht	Ndërprerje operacionale për forcë madhore (COVID), jo vonesë ndërtimi.
Garanci minimumi (de facto)	Po	Pagesë për 475,000 kontrolle pavarësisht realizimit. Mbipagesë e konstatuar nga KLSH
Volum i planifikuar i papërmbushur	Po	Projeksioni 475,000/vit nuk u arrit deri në 2019 dhe me magësi në çdo vit tjetër operimi.
Mungesë studimi VfM / PSC	Po	Nuk gjendet publikisht studim i vlerës së parasë
Klauzola kompensimi jo simetrike	Po	Pagesa për kontrolle të pa realizuara.Ekziston mekanizëm mbartjeje/kompensimi me ndryshimin e kontratës në 2016 e cila kërkon analizë të detajuar.
Mungesë raportimi institucional vjetor	Jo	Raportohet rregullisht në RVP/DRF

[19]Tavani fiskal sipas nenit 4/2 të Ligjit Nr.9936, datë 26.6.2008 (shtuar me ligjin nr. 57/2016): pagesat vjetore neto nga kontratat koncesionare/PPP, si rregull, nuk duhet të tejkalojnë 5% të të ardhurave tatimore faktike të vitit paraardhës.

Sinjale alarm	Prezent?	Vërejtje
Dokumentacion tenderi i padisponueshëm	Po	DST të sekuestruara nga SPAK (sipas MSHMS)

6. Gjetjet kryesore dhe kufizimet

Gjetjet kryesore

- Kontrata është një PPP **pagese për disponueshmëri**, e financuar nga buxheti dhe falas për përdoruesit. Barra kryesore financiare janë pagesat korrente vjetore, jo investimi fillestar. Logjistika përbën një pjesë të konsiderueshme të projektit në raport me analizat laboratorike.
- Pagesat totale të dokumentuara 2015–2025 arrijnë **rreth 8.05 miliardë lekë**, me një angazhim minimal vjetor të garantuar prej 876 milionë lekë (me TVSH) pavarësisht kërkesës reale.
- Risku i kërkesës, megjithëse formalisht te privati, **ndahet de facto me shtetin** përmes minimumit të garantuar për projeksionin prej 475,000 kontrolle/vit. Ky nivel është tejkaluar vetëm në vitin 2019, dhe KLSH ka konstatuar mbipagesë për shërbim të pakryer (930 mln lekë për 2015–2019) që arrijnë **në 809 milion lekë deri në 2025.**
- Risku i forcës madhore u materializua gjatë COVID-19 (pezullim mars 2020–shtator 2021), gjendje e cila çoi në **zgjatjen de facto të afatit deri në 2027**. Megjithëse nuk kemi siguruar asnjë burim zyrtar informacioni për ta konfirmuar këtë fakt.
- Ndryshimi i vitit 2016 me zgjerimin e grupmoshës në 35–70 dhe shtimin me dy analiza të reja është **zgjerim ligjor pa rritje çmimi** dhe nuk është pasoje e ndonjë anomalie kontraktuale. Sidoqoftë, KLSH ka evidentuar mangësi në fazën paraprake të studimit të fizibilitetit dhe planifikimit të nevojave reale për këtë shërbim.
- Transparenca është **e moderuar (indeks 3/5)**. Raportim fiskal është i rregullt, por pa kontratë lehtësisht publike, pa studim publik mbi vlerën e parasë (VfM) dhe me dokumentacion tenderi jo të aksesueshme.
- KLSH ka konstatuar **pagesa për shërbime të pakryera dhe ka kërkuar rishikimin e kontratës** (lidhur pagesë vetëm për koston variabël), si dhe ka ngritur pyetje mbi rezultatet shëndetësore të lidhura me objektivin kryesor të këtij projekti. Kjo mbetet një çështje për tu analizuar mbi vlerën e parasë publike.

Kufizimet e analizës

- Analiza mbështetet në informacionin e disponueshëm. Mungesa e dokumenteve të tenderit dhe e studimit VfM kufizon verifikimin e fazës së prokurimit dhe të vlerës së parasë.

- Disa të dhëna paraqiten të ndryshme nga burime të ndryshme, kryesisht lidhur me numrin e shërbimeve të realizuara apo pagesat e kryera apo dhe vlerën e kontratës. Lidhur me këto pasaktësi në raport janë përfshirë shënime specifike shpjeguese lidhur me diferencat dhe burimet e informacionit.
- Të dhënat për një zgjatje të mundshme kontraktuale përtej 10 viteve të parashikuara në kontratën fillestare nuk janë të qarta në dokumentacionin e marrë. Statusi përfundimtar ende duhet konfirmuar me autoritetin. Për këtë raport janë përdorur vetëm burimet alternative mediatike.
- Raporti përfshin llogaritje dhe vlerësime të cilat bazohen në gjykim profesional dhe duhen lexuar si **bazë për debat dhe kërkim të mëtejshëm**, jo si konkluzione përfundimtare.

Interpretimi i rezultateve

Gjetjet e këtij raporti nuk janë konkluzione përfundimtare mbi performancën financiare apo ligjore të kontratës. Çdo gjetje referon burimin përkatës dhe shoqërohet me dokumentacionin mbështetës, në përputhje me parimet e neutralitetit analitik, krahasueshmërisë dhe replikueshmërisë.

Burimet kryesore

- MSHMS - Shkresë përcjellëse nr. 2224 Prot., datë 04.05.2026 (përgjigje ndaj kërkesës për informacion).
- Kontratë Koncesioni nr. 3082/20 Prot., datë 07.01.2015 (MSHMS - 3P Life Logistic sh.p.k.).
- Kontratë për financimin e koncesionit (FSDKSH - 3P Life Logistic), datë 08.01.2015.
- Kontratë shtesë nr. 5318/3 Prot., datë 30.11.2016 (VKM nr. 721/2016).
- MSHMS - Tabela e pagesave totale të koncesionit Check-Up, 2015–2025.
- Ligj nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”; VKM nr. 185/2014; VKM nr. 721/2016; Ligj nr. 10383/2011.
- Ministria e Financave - Raporti Vjetor i Përmbledhur (RVP) 2023 dhe 2024; Deklarata e Risqeve Fiskale (DRF) 2023 dhe 2024.
- KLSH - Raport mbi zbatimin e buxhetit të shtetit 2023.
- KLSH - Raport përfundimtar i auditimit auditim i përputhshmërisë në drejtorinë e përgjithëshme të FSDKSH (2019-2020), (2024).
- Burime të tjera mediatike të referuara në raport mbi detaje të ndryshme lidhur me kontratën dhe eventeve gjatë periudhës së operimit.

Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit "Strengthening capacities for the sustainable monitoring of public contracts", pjesë e programit Matra 2024. Përmbajtja e këtij dokumenti reflekton pikëpamjet e autorëve dhe nuk përfaqëson domosdoshmërisht qëndrimin apo politikat zyrtare të Ambasadës së Mbretërisë së Vendeve të Ulëta në Shqipëri. Ambasada nuk mban përgjegjësi për përdorimin e informacionit të përfshirë në këtë raport.